



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:086405

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06165106

KPPP.nr. 512/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Toska Group” L.L.C., me numër unik identifikues 811947342 dhe seli në Gjilan, rr. “Beqir Musliu”, nr. 83, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arton Haziri, avokat nga Gjilani, kundër debitorit “K.B.” B.I. – N.P.T “F...”, me numër unik identifikues ... dhe seli në Mitrovicë, rr. “Shemsi Ahmeti”, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 241/24, të datës 16.02.2024, të lejuar nga Përbaruesi Privat Përparim Xhelili nga Gjilani, jashtë seancës me datë 16.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “K.B.” B.I. – N.P.T “F...”, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 241/24 i datës 16.02.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Përparim Xhelili, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 78.00 (shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Toska Group” L.L.C., me datë 16.02.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 241/24, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve: Faturë nr. 23-TGR-0170, e datës 30.01.2023; Faturë nr. 23-TGR-0171, e datës 30.01.2023; Faturë nr. 23-TGR-0518, e datës 13.03.2023 dhe Faturë nr. 23-TGR-0519, e datës 13.03.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “K.B.” B.I. – N.P.T “F...”, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj

kreditorit shumë prej 771.87 EUR (shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro e tetëdhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumë prej 104.00 EUR.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbarimor, me arsyetimin se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk janë të përshtatshme për përmbarim sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare, andaj duke u mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit mes kreditorit dhe debitorit çfarëdo kërkesë për kompensim pa barazimin e obligimeve financiare është në kundërshtim me marrëveshjen mes palëve. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në prapësim ka theksuar se debitori ka paraqitur prapësimin duke mos u bazuar në asnjërin nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi dhe se urdhri përmbarimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm, respektivisht faturave sipas nenit 29, par. 1, pika 1.3 të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet për mos barazim të obligimeve financiare janë të pabazuara pasi që sipas marrëveshjes për bashkëpunim me debitorin ka bërë barazimin, ku nga shuma totale e faturave të pa paguara ka zbritur bonusin vjetor, zbritjen dhe kthimin e mallit, e për të cilën ka qenë i informuar edhe debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 104.00 EUR.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është*

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumentet: Fatura nr. 23-TGR-0170, e datës 30.01.2023; Fatura nr. 23-TGR-0171, e datës 30.01.2023; Fatura nr. 23-TGR-0518, e datës 13.03.2023 dhe Fatura nr. 23-TGR-0519, e datës 13.03.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e pasqyruar tek pranuesi i secilës faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t’i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të propozimit për përmbarim të ushtruar në vlerë prej 104.00 EUR dhe përgjigjes në prapësim të ushtruar në vlerë prej 104.00 EUR, në shumën e përgjithshme prej 208.00 EUR, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve të datës 18 mars 2017, nr. tarifor 6, lidhur me përmbarimet në bazë të dokumentit të p mbi në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël .

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 512/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.